




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN



VENDIM

Nr.4, datë 04.07.2022

PËR

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES SË PËRDORIMIT TË
BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM
HIDROENERGJETIK, ME NR.21/2 PROT., DATË 03.05.2017
DHËNË NGA KBU SHKUMBIN, SUBJEKTIT “ERDY ENERGY”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes së përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik, me nr. 21/2 prot., datë 03.05.2017 dhënë me vendim nr.16 datë 25.04.2017 nga KBU Shkumbin, subjektit “Erdy Energy”, me adresë Njësia Administrative Qendër Librazhd Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Kalis

Vepra e marrjes

- $X = 520020$; $Y = 4568786$; $Z = 347$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja mesatare $Q_{mes} = 2.97$ m³/s

- Prurja ekologjike $Q_{eko} = 0.54 \text{ m}^3/\text{s}$
- Sasia e ujit që jepet në përdorim $Q = 5 \text{ m}^3/\text{s}$

Godina e Centralit

- $X = 524404$; $Y = 4566357$; $Z = 272 \text{ m.m.n.d. (KRGJSH)}$

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

MAJLINDA PERRIU

